



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC**

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL PËR LËVIZJE PARALELE, NGRITJE  
NË DETYRË DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË E  
MESME DREJTUES**

**Pogradec më 18 / 04 / 2017**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave, Njesia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore pranë Bashkisë Pogradec shpall procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme drejtuese për pozicionin :

**1 (Një) Pozicion – Drejtor në Drejtorinë e kontrollit, planifikimit dhe zhvillimit të territorit, Kategoria e pagës II-b**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakante, është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të gjitha procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LEVIZJE PARALELE: 28 Prill 2017

Afati për dorëzimin e dokumentave për NGRITJE NE DETYRE: 4 Maj 2017

## **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin:**

- **Drejtor në Drejtoria e kontrollit, planifikimit dhe zhvillimit të territorit**

-Është punonjës civil në varësi direkte nga kryetari i Bashkisë.

-Përfaqëson Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të zhvillimit të territorit në të gjitha marrëdhëniet e saj me sektorët e tjerë të Bashkisë, institucionet e ndryshme dhe me gjithë organet shtetërore, vendore e qendrore për problemet që kanë të bëjnë me planifikimin e territorit dhe zhvillimet urbane në qytetin e Pogradecit.

-Ndjek punën dhe detyrat e ngarkuara brenda Drejtorisë dhe në lidhje me problemet e Planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit të territorit të qytetit.

-Organizon punën studimore dhe propozon masat konkrete në drejtim të mbarëvajtjes së problemeve të urbanizimit të qytetit.

-Organizon dhe ndjek punën për koordinimin e kërkesave të subjekteve juridike apo fizike me politikatat urbane të Bashkisë Pogradec.

-Informon në mënyrë periodike eprorin direkt për problemet e ndryshme në lidhje me zbatimin e legjislacionit në fushën e planifikimit të territorit dhe kontrollit të zhvillimit.

-Kryen vlerësime të punonjësve në varësi.

### **1.LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

#### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

##### **Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a.Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda kategorisë II-b ;
- b.Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c.Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

##### **Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a.Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Arkitekturë, Inxhinieri.
- b. Edhe diploma e nivelit Bachelor të jetë në të njëjtën fushë.

#### **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

##### **Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë**

- a-Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);

- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen pranë zyrës së burimeve njerzore pranë Bashkisë Pogradec ose të dërguara me postë.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për lëvizjen paralele duhet të bëhet brenda datës: 28 Prill 2017

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Ligji nr 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e teritorit".
2. Ligji nr 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”
3. Ligji nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, i ndryshuar;
4. VKM nr. 1055 datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të Ndërtimit”
5. Vkm nr 408, datë 13.5.2015" Për miratimin e rregullores së zhvillimit të teritorit.
6. Vendim nr .554 , datë 18.06.2015 " Për shpalljen e qëndrës historike të qytetit të Pogradecit dhe miratimin e rregullorës për administrimin e saj.

### **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

## **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Bashkisë Pogradec do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga NJMBNJ, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

## **2.NGRITJA NE DETYRE**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lire si dhe kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil.

### **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë III-b, IV-a ose IV-b;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët për pozicionin Drejtor duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Arkitekturë , Inxhinieri. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 3 vjet përvojë pune në administratën publike, prej të cilave 1 vit përvojë pune lidhur me fushën përkatëse të pozicionit të punës.
- c- Të kenë njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze dhe aftësi për komunikim efikas dhe të qartë në këtë gjuhë.

### **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin europian;
- b -Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d -Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;  
i -Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;  
Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet dorazi pranë sportelit të informacionit ne Bashkinë Pogradec ose të dërguara me rrugë postare.  
Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave online për procedurën e ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil duhet të bëhet brenda datës: 04.05.2017

### **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën 07 Maj 2017, Njësia e Menaxhimit të burimeve Njerëzore do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

### **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- 1.Ligji nr 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e teritorit".
- 2.Ligji nr 8402, datë 10.9.1998 'Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit.
- 3.Ligji nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, i ndryshuar;
- 4.VKM nr. 1055 datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit
- 5.Vkm nr 408, datë 13.5.2015" Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit.
- 6.Vendim nr .554 , date 18.06.2015 " Per shpalljen e qendrës historike të qytetit të Pogradecit dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

### **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

**a-**Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;

**b-** Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;

**c-** Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

## **2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJMBNJ do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për rezultatet nëpërmjet (adresës së e-mail). Brenda tre ditëve kalendarike nga njoftimi individët kanë të drejtë të paraqesin ankesa me shkrim pranë zyrës së Burimeve Njerëzore.